

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

**BOTIME TË VEÇANTA CLVIII
SEKSIONI I ARTEVE
LIBRI 22**

Rexhep Ferri

Ibrahim KODRA

(MONOGRAFI)



2016

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

SPECIAL EDITIONS CLVIII
SECTION OF ARTS
BOOK 22

Rexhep Ferri

Ibrahim KODRA

(MONOGRAPH)

Approved for publication at the meeting of the Arts Section,
held on 6th May, 2016, after review by
correspondent member Xhevdet Xhafa and correspondent member Luan Mulliqi.

Editor: Correspondent member Luan Mulliqi,
Secretary of the Arts Section

Prishtina
2016

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

BOTIME TË VEÇANTA CLVIII
SEKSIONI I ARTEVE
LIBRI 22

Rexhep Ferri

Ibrahim KODRA

(MONOGRAFI)

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Arteve,
mbajtur më 6 maj 2016, në bazë të recensioneve të
anëtar korrespondent Xhevdet Xhafës dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqit.

Redaktor: Anëtar korrespondent Luan Mulliqi,
Sekretar i Seksionit të Arteve

Prishtinë
2016



PORTRETI I BOTËS SË RE

1

Përtej detit, në një tokë të huaj, një student shqiptar ndjek yllin e vet. Më 1958 Vivien Bast pat thënë për të: "Ibrahim Kodra e ka pikturuar muzikën e tij". Ky vlerësim nuk është ëndërr mashtruese. Në revistën ku ishin të shkruara fjalët për Kodrën kishte diçka tërheqëse dhe rrëqethëse për mua. Aty ishin të botuara disa piktura, që mbanin emrin e tij.

Dhjetë vjet më vonë, Ibrahim Kodra, për të kapur lidhjet me popullin e vet, erdhi në Kosovë. Përshtypja e parë ishte: Kodra i lodhur nga vitet e vetmisë dhe Kodra i poezisë më të bukur në pikturën shqiptare. Në të parë pikturat e tij ishin tërheqëse, të mbushura me atmosferë; të afërta, çuditërisht si të pashijuara prapë, befasuese dhe nostalgjike. Përngjasimi mes nesh e kishte edhe të fshehtë e vet për brezin e parë të piktorëve dhe krijuesve në Kosovë. Arti dhe mendimet e Ibrahim Kodrës ishin të afërta. Natyra e tij edhe kur përpiquej të ndryshonte diçka, një kujtim i gjallë, një drejtpeshim i afërt e kthente në botën e tij të njohur.

Larg dhe afër, Kodra është njohës i mirë i artit antik dhe modern. Në rini bëri studime të larta për kufijtë e kohës. Në pikturat e tij ka diçka të mozaikut e të dekorimit të artit popullor, të pikturës monumentale, të kubizmit, të Pikasos së viteve të *Guernikës*, të piramidave egjiptiane, të sarkofagëve të faraonëve, të portave orientale dhe të dritareve të fëmijërisë së tij, si dhe të arritjeve më të reja të artit modern. E gjithë kjo yllësi e largët dhe e afërt reflektohet si dritë. Ibrahim Kodra nuk është marrë kurrë me kopjimin e natyrës. Bota e madhe e gjithësisë në veprën e tij shndërrohet në një drejtpeshim të ri. Në mënyrë të çuditshme artistët përvetësojnë vlera. Nuk ka rrethana të caktuara. Ndjenja për të pikturuar shfaqet si dëshirë. Gjatë kërkimeve, prishja e natyrës së vdekur nuk përjetohet si fatkeqësi. Për të kaluarën e saj dimë dhe s'dimë shumë. Portreti i botës së re krijohet pas tragjedive të mëdha.

Figura në enterier, figura në hapësirë, hapësira dhe njeriu, studimi i natyrës, i imagjinatës, studimi i botës bimore e shtazore, rritja e trajtave përtej masës së natyrshme ose zvogëlimi i tyre - për të gjitha këto kujdeset imagjinata. Prandaj Kodra me gjuhën e vet të qartë nuk e kufizon realitetin e vet artistik. Për të gjitha orientimet konsultohet me profilin, që e krijon me kohë. Prezantimet e tilla nuk harrohen. Dhe duke qenë i durueshëm, Kodra ia mundëson vetes të arrijë atë që e ëndërrojnë të tjerët.

Në "lindjen" e pikturave të Ibrahim Kodrës ka edhe skllavëri. Kjo rrugë e pandryshueshme është dhe rruga e tij e vetme. Çka nuk sjell koha, por shkojmë andej nga na pëlqen. Kështu figurat gjeometrike Kodra i ka për të gjitha trajtat dhe imagjinatën, duke e kombinuar me një drejtpeshim, ku takohen matematika dhe poezia.

Ne që kemi lindur një ditë para fotografisë lehtë e kemi të futemi në muzikën e pikturave të Ibrahim Kodrës. Bindemi në këngën e vetmisë së tij, bindemi se fjalët dhe përmbajtjet janë të ditëve tona. Nga toka e fjetur kuptohen lehtë: një këngë, një kujtim dhe një kohë që shfaqet si ngjyrë, si mollë, si muzikë.

Të gjitha këto shpalime janë ndoshta vjeshtë mbretërore.

I ngujuar në kullën e vet, Kodra e pikturon vetminë, ëndrrën si nevojë e si nostalgji...

Një shëtitje e muziktarëve të Pikasos e shoqëroi gjatë, shumë gjatë.

Piktura është mjeshtri. Kodra e ka shenjën dhe kohën e vet. Para syve të botës është një profil, një brez. Për ne, një vitrazh i qytetëruar. Ushtarët e Kodrës janë përmendore e latuar. Mund të jetë e kapshme për të gjithë. Djaloshi me fyell e ka profilin dhe buzëqeshjen e hënës. Si Leonardo da Vinçi piktori ynë e shikon qiellin. Është i rrethuar me Zotin e vet.


Por hapësira mes gjuhës së gjallë krijuese dhe të shumë pyetjeve të tjera është botë e panjohur, optikë e artit të lashtë dhe të artit të kohës. Kodrën e gjejmë afër natyrës, edhe pse nuk e kopjon, ai atë e rikrijon. Interesimi i tij ka ndjeshmëri artistike dhe njerëzore, ka reflekset e poezisë simbolike, ka vlerësimet dhe rivlerësimet e shumta. E kaltra, e kuqja, e gjelbra dhe e verdha, edhe pse me shkëlqimin e tyre përsëriten në disa piktura, brenda vetes ato e krijojnë lirinë e vet.

E vërteta artistike krijon një rreth të jashtëm, bëhet botë e fshehur të cilës i takon fryma që e kërkohet. Asaj i takon edhe leximi i heshtjes.

Çdo krijues e ka kohën e kërkimeve dhe kohën e përsëritjeve. Ibrahim Kodra si krijues është i vetmuar. Në pikturat e tij nuk ka lëvizje të dendura mes pikturës për të gjitha figurat, idhujt, instrumentet muzikore në pozita frontale dhe dydimensionale. Kodra ecën rrugës nëpër të cilën kishte kaluar një ditë ose pesëdhjetë vjet më parë. Për të fituar dritën e duhur pajtohet me atë që e ka thënë dikur.

Në historinë e sotme të arteve nuk ka rregulla krejtësisht të caktuara. Formimi i personalitetit identifikohet me moralin. Drama që luhet nuk është botë vetëm e këtij qytetërimi. Fantazia nxori në dritë metaforën e re. Vizioni artistik është vazhdim i ëndrrës. Kodra nuk vrapon. Që të mos lëndohet imazhi, ai e di se çka e drejton. Hapësira e pikturave të tij e ka një religjion, një frymë mitologjike. Sipërfaqet gjeometrike në pikturat e tij marrin vlerën e një takimi të ëndërruar. Në një paradë, ku shihet parakalimi i ushtarëve, koha ka hapin e njëjtë dhe profilin e njëjtë.

Kodra është i sigurt. Jeton nga fshehtësia e një vetëdije ku piktori i ëndrrave me gabimet e bukura arrin ta bind vetveten dhe ta kuptojë se ku ndodhet. Në veprën e tij praktikisht aplikohet pushteti sovran. Drejtpeshimi i shërben ta kapë një kohë, thjesht një mundësi. Pronësia e tij nuk shkon me natyra të tjera. Koha për t'u njohur nuk është e humbur.



Originaliteti i Kodrës është gjithmonë i njëjtë, i mjaftueshëm, i njohur. Edhe pse njohu qytetërimi dhe hapësira të stileve të ndryshme, ai u ndal aty ku e pa ëndrrën e vet. Dashurisë së tij gjithmonë i ka mjaftuar Kodra. Në Milano të Italisë Kodrën e kam parë disa herë në studion si e fillon ditën. Me lëvizjet e para asgjë nuk rrinte pezull. Gjatë pikturimit i caktonte hapësirat dhe pjesët e veçanta. Kjo s'ishte vetëm matematikë, as shpikje. Aty kërkoheshin lidhjet shpirtërore me botën e re. Aty ishin ngjyrat, brushat, muret e bardha, pikturat, tryeza e punës, tavolina dhe karrigia e pushimit, dritarja e hapur dhe qielli i vogël si peizazh. Dhe pa vështirësi sipërfaqet fillonin të mbusheshin me ngjyrë, por jo me çdo kusht. Për veten thoshte: “Herët, jo në fillim, e gjeta një çelës. Një çelës jo për të hapur dyer të zakonshme, por të pahapura”.




Në plazh,
tush në letër,
50 x 35 cm
1966


Me kënaqësi të madhe pikturon detin. Shihet se e kaltra ka qenë fëmijëria e tij, me ngjyrën e kaltër krijoi një mijë e një piktura të bukura dhe me kohë e përsosi shijen. Personaliteti i tij në pikturë është sovran.

Katërkëndëshi i Kodrës është gjenial. Në të lind portreti. Aty fillon lidhja e dashurive të tjera. Në pikturat e tij udhëton muzika, ajo nuk mban fjalime. Me një kubizëm lirik dëshiron të ndalet në rrafshin e emocioneve. Imagjino fakte. I vetëdijshëm për sukses, e di se kur dhe ku duhet të ndalet.

Koha me ndryshimet e mëdha nuk duron iluzione. Kodra e respekton lirinë e vet krijuese, ëndërrën e shndërron në realitet. E kërkon ditën kur janë të pranishëm dielli dhe hëna. Përshkrimet për artin e tij janë të panevojshme, nuk ka shumë kohë për të menduar. Zgjidhja e problemit të origjinalitetit punon për të, vazhdimisht është këmbëngulës të punojë siç e vlerëson logjika e tij. Qëndrimet tradicionale janë tejkaluar. Për ritualitetin e vet ky ka shumë pyetje. Nuk mund ta kuptojë veten pa zgjedhjen e finesave dekorative. Shkëlqimet e natyrës së vogël në pikturën e tij janë detaje të bukura. Edhe kur i bie në dorë ndonjë gjë e re, e aplikon dhe e adapton atë. Natyra e stilit të tij është e fuqishme.

Nudo,
bojë kine në letër,
39 x 49 cm
1960





Kuaj,
bojë kine në letër,
35 x 49 cm,
1958

Krijimtaria e Ibrahim Kodrës brenda largësive të veta nuk shtrihet e ngrirë vetëm si vetëdije e kubizmit. Ai pikturën e vet nuk e ngarkon me detaje të tepërta, por e mbush me ngjarjet e natës me hënë. Aty e atëherë kur njerëzit kërkojnë kohë të lirë për t'u takuar në një ikonë të ngjashme me ëndrrat e tyre.

Për të gjetur atë që kërkon, Kodrën e tërheq magjia e pikturave të njohura. Drita e largësive të afërta duke harruar shekullin, kërkon ide të reja që përfaqësojnë historinë e hijeve tona. Aty e atëherë kur për një kohë tjetër parashikimet i nxjerrim nga lumi, oqeani, deti.

Nëse dëshironi ta gjeni veten në pikturat që i krijon Kodra, nuk bëni asgjë të re, por do t'i kaloni vetëm disa çaste të mira. Ky vit nuk është i kaluar. Nuk ka kohë të merret me gjëra, të cilat s'i kemi paraqitur si të kohës. Kur flasim për Kodrën në kuadër të kombëtares, ky shpirtërisht mbetet gjithmonë brenda jetës shqiptare. I ri, i pazëvendësueshëm, preciz. Kur u paraqit, çfarë date ishte për ne? Arti modern i këtij shekulli për ne shqiptarët fillon me Kodrën apo pas Kodrës? Kush do ta vlerësojë këtë punë? Rendi shtëpiak nuk dihet ende. Kodra nuk është ende sa duhet në mjedisin tonë. E lamë përtej detit...

2

Më 1938 Ibrahim Kodra fitoi një bursë për studime nga Nëna Mbretëreshë e Shqiptarëve. Studimet për pikturë i filloi në Itali, në Akademinë "Brera" në Milano, në klasën dhe studion që e drejtonte piktori i njohur Carlo Carra.

Pas studimeve Kodra shpejt filloi të radhitet ndër piktorët e mirë të brezit dhe të frymës së re krijuese.

Më 1944 hap ekspozitën e parë personale në Milano.


Pas Luftës së Dytë Botërore edhe pse nuk e dinte se çka e pret as ai vetë, nuk e tha se çka e pengoi apo çka e ndali që të mos kthehej në Shqipëri.

Nga mesi i shekullit të njëzet pas Guernikës, e pas Zonjushave të Avinjonit, e pas Muzikantëve të Pikasos, edhe për Kodrën fillon diçka e re dhe mbaron përsëritja e kopjimit të natyrës. Shpirtërorja e brezit të ri filloi të kërkonte dhe të pikturonte atë që nuk e njihnte, atë që nuk e dinte dhe atë që e kërkonte.

Kjo vetëdije e imazhit të ri Ibrahim Kodrën e gjen duke kërkuar autoportretin dhe pasqyrën e vet.

Figurë,
teknikë e përzier në karton,
35 x 50 cm,
1966





Për botën që rri gojëhapur për të qeshur, për të kafshuar, ku e ku më larg, e ku e ku më afër, Kodra e kishte kuptuar se “kur rrëzohesh duhet ngritur përsëri”. Me besimin dhe këmbënguljen e Mitit të Sizifit e parashikoi fatin si piktor edhe përtej mundësive.

Duke harruar legjendat e duke kërkuar shekullin krijohet dhe rikrijohet thjeshtësia e re artistike. Nga bukuria që ruhet e fshehur si thesar, Ibrahim Kodra me kohë e kishte të njohur se në Kinën e largët për fëmijët e porsalindur kërkohet heshtja e një peme për t'u bekuar nga gjethet.

Para historisë e pas historisë Ibrahim Kodra e takon Ibrahim Kodrën. Mes dy dritareve pa edhe Murin Kinez. Për këtë çmenduri të bukur as evropianizmi nuk po gjen përgjigje.

Me vetminë e kërkimeve, gjetjeve, kur drita bie mbi ngjarjet e natës me hënë e dita e humb ditën për të mbledhur gurët e mozaikut dhe kuptimet e fragmenteve të vogla të inspirimeve dhe gjetjeve.

Për fillimin dhe krijimin e natyrës, për të humbur e gjetur ëndrrat gjatë atyre viteve Kodrës shpesh i kujtohet edhe shëtitja e Pikasos dhe poezia e Zhak Preverit:

një mollë bën pozë/ballë për ballë saj/një piktor realist/provon të pikturojë kotësisht/mollën ashtu si është/por/ajo nuk do të pikturohet/molla/edhe ajo ka ta thotë fjalën/dhe shumë mashtrime në shakullin prej molle/

e piktori i humbur humb pamjen e modelit/dhe fle/Kështu Pikasoi pra/Që kalonte andej siç kalon gjithkrah/Çdo ditë si në shtëpi të tij/Sheh mollën e pjatën dhe piktorin e fjetur/

Ç'ide të pikturosh një mollë/Tha Pikasoi/Dhe Pikasoi hëngri mollën/E molla i tha Falemnderës/E Pikaso theu pjatën/E vajti në të qeshur/Piktori i shkullur nga ëndrra/Siç shkulet një dhëmb/U gjet fare vetëm para pikturës së pakryer.

Gjatë atyre fillimeve Evropa vlonte nga gjetjet dhe kërkesat e reja për Evropën e Plakur, për Evropën e dalur nga luftrat qytetare dhe Evropën në kërkim të vetvetes.

E pabesueshme, por e vërtetë.

Evropa e atyre viteve ishte në hall me ndarjen nga bota e vjetër që ende jetonin me historinë e kuptimeve të kontrasteve të mëdha...

Por koha dhe vitet e mësuara me të kaluarën nuk zgjatën shumë. Për një fat të pritur, për një vlerë më shumë artistët e rinj shkuan edhe përtej Guernikës së Pikasos.

Por Ibrahim Kodra, duke kaluar përtej Guernikës së Pikasos, shkoi të zbulojë diçka që nuk e kishin zbuluar piktorët e tjerë të kubizmit e të thirrjes mistike gjeometrike të Pol Klesë.

Qëllimisht e thjesht, meditative, e kuptueshme.

Prej fjalës në fjalë, prej muzikës në muzikë, prej lojës figurative në lojë figurative deri te leximi i pikturave të botës moderne që fillon te gjetjet e fragmenteve, e meditimeve që shtrihen deri te mundësitë e shkuarjes edhe përtej të njohurës për t'u shprehur si krijues. Ku leximi i bukur i fushëpamjeve në pikturat e Pol Klesë ka miliona ëndrra për njerëzimin dhe kohën, për të mos thënë për jetën dhe shprehjen e shpirtërores dhe të dukurive shpresëdhënëse për mendimin dhe shtrirjen e shprehjes së pikturës moderne, por edhe Ibrahim Kodra me krijimtarinë e vet shprehi një liri pa ndikime e pa paragjykime dhe pezantohet si brez që krijoi një ndarje me vi të kuqe. Mes reales dhe ëndrrës metafora e mozaikut bizantin Ibrahim Kodrës ia ka çelur rrugën për kontakte të reja me thesarin e lindur nga shpirtërorja e krijimtarisë popullore.

Për brushën e tij kishin kaluar vitet me mjegullat e iluzioneve.

Por Ibrahim Kodra për besimin e vet krijues gjen diçka më të mirë e më të ndryshme se kopjimin, dhe pak më ndryshe se të tjerët, nga koha që e kishte kaluar si i ri në Shqipëri e para se të kalonte detin e të shkonte për të ushtruar pikturën në Milano ku mbeti për të jetuar. Nga malli për vendlindjen dhe kohën e rinisë që e kishte jetuar dhe nga tabela orientuese që e kishte pikë orientimi, ku mund të humbet edhe fillimi, Ibrahim Kodra me fijet që i ruajnë kujtimet e me dashurinë që i beson dashurisë gjatë rrugës Ignatia, me disa fragmente e gjetje, për fatin e vet morri bekimin. Para pasqyrës pa ëndërrën e vet. Përtej pamjes së një fotografie shpesh i rikujtohen shtëpitë e banimit të tipit oriental. Me detaje e dekorime të dritareve, dyerëve, dollapeve, kutiave e djepave të dekoruara nga dera e mjeshtrit të drurit; me variante të ndryshme të renditjeve të trekëndëshave dhe katërkëndshave e kutijave të kubizmit. Larg e afër hamendjes së fundit të historisë së kabizmit, Ibrahim Kodra gjeti artin e vet dhe jetën e merrte ashtu siç i vinte.

Gjatë atyre viteve të cilat e sollën edhe shpikjen e robotit e të robotizmit, deshëm e s'deshëm arti prapë mbeti një ëndërr, një kërkesë që i njohim edhe pa i takuar kurrë. Ajo ndjenjë shpirtërore nuk kapet aq lehtë as me shpejtësinë e sekondës e as me shpejtësinë e aparatit fotografik. Për ta ruajtur e për ta përjetuar këtë vetmi din vetëm kënga arbëreshe "Lule lule maca maca e lule lule maca maca".

Ishin të rinj,
teknikë e përzier në letër,
50 x70 cm,
1975





Vizatim,
1944

Por mes këtyre dy gjetjeve ka edhe shumëçka për t'u thënë e për t'u parë se Kodra botën e vet e ka gjetur brenda vetvetes dhe nga kënga në këngë me konceptin e shprehjes së kubizmit, që kalon nga stina në stinë. Por ai me gjeometrinë e trekëndshave, katërkëndshave Kodra e takon dhe e përshëndet Kodrën. Aty e atëherë kur para pasqyrës, në dritë të pastërt e me ngjyrat e shtatë ngjyrave e shpreh portretin e ëndrrave të veta.

Siç e thashë më lart, Kodra herët e gjeti çelësin e vet. Me shprehjen e vet dalluese krijon një distancë me piktorët e brezit e të kohës së vet.

Me këto vlerësime nuk dua të caktoj vlerat historike të pikturës së Ibrahim Kodrës e as të shprehi afinitetet e mia dhe as të them se në çfarë ujërash gjendej shpirtërorja e atyre viteve të artit shqiptar.

Ngjarjet dhe shijet kurrë s'kanë qenë të njëjta.

Për vlerat antike që kanë diçka artistike dhe personale, më mirë se ne flasin zotërat, por meqenëse tani jemi afërt me Autoprotretin e Kodrës para pasqyrës, për hir të origjinalitetit jemi edhe në shërbim të origjinalitetit, që na vjen nga piktura në pikturë, me një poetikë në kufijtë e një kubizmi që vjen si lirikë e pastër, për të mos thënë një romantizëm i ri në fushën e kubizmit.

Kjo paraqitje përjetohet si vlerë e pakrahasueshme, thjesht mund të konsiderohet si mit i vetvetes dhe jeton për ta ruajtur ëndrrën e vet dhe të fshehtat mashtruese të çdo dite, të çdo kërkesë.

Me një të vërtetë aq të thjeshtë sa herë na vjen të besojmë edhe kur nuk është për të besuar...

Kodra çdo pikturë e përfundonte me atmosferë dhe frymë optimiste. Nga i vinte gjithë ky besim dhe shprehje me dritë natyrale nuk e dinte as ai vetë. Bota nga distanca e nga largësia e afërt ndoshta i vinte për ta gjetur foshnjërinë dhe fëmijërinë e humbur. Pas vdekjes së nënës, për të shpëtuar nga vuajtjet dhe rrethanat e padurueshme nga njerka, gruaja e dytë e babait, në moshën tetëvjeçare ik nga shtëpia e babait dhe edhe pse ende ishte shumë i vogël për një vendosje të tillë, shkon në Durrës. Hap pas hapi, duke humbur e gjetur vetveten pa e ditur se ku do ta zërë nata me natë e ku do ta gjen dita me ditë, nëpër lagjet dhe rrugët e panjohura të Durrësit e të Tiranës, Kodra i ri i sheh ëndrrat e Sizifit dhe bindet se e vërteta nuk është gjithmonë e mirë dhe e kuptueshme.



Figurë,
bojë kine në letër,
48 x 36 cm,
1963

V. centenario della
morte di
Skanderbeg
1468 - 1968



Nga cikli:
Monumenti i Skenderbeut në Bruksel,
1968.

3

Kur jeta në art pret një përgjigje, Kodra më 1958, në Bienalen e Venecies paraqitet si përfaqësues i Shqipërisë.

Më 1967 merr shtetësinë italiane dhe më 1968 viziton Kosovën.

Në Prishtinë hap një ekspozitë personale, me një kulturë të lindur mes Lindjes dhe Perëndimit, të kulturës evropiane dhe të kulturës botërore, duke dalur nga legjenda dhe duke hyrë në një botë tjetër.

Për pushime si piktor shkon shpesh në Jug të Italisë, mes arbëreshëve, ku mbrëmjeve nga zjarri dhe tradita dhe nga dashuria për tokën këndohej kënga "O e bukura More, ku të lash e më s'të pashë". Një dashuri e pakufishme përtej detit.

Ibrahim Kodra, kur erdhi për herë të parë në Prishtinë për të hapur një ekspozitë personale, atëherë Kosova ishte një copë Evropë e humbur dhe e shtrirë në zemrën e Ballkanit, ku pas Luftës së Dytë Botërore, në artet shqiptare përsëritej Legjenda e Misrit. Aty e atëherë, ku në fund të mitit përfundon çdo gjë dhe fillon historia e një udhëtimi me fat apo pa fat...

Me historitë e shkruara e të pashkruara, Kodra na kishte ardhur nga kubizmi lirik i përqendruar brenda kubizmit lirik të shtrirjeve evropiane.

Gjatë atyre viteve një erë e lehtë e atyre vlerave kishte mbërri edhe deri te ne në Prishtinë. Prandaj ekspozita e Kodrës në Prishtinë, edhe pse për ne ishte një risi e panjohur, nga etnografia ballkanike me të cilën Kodra i kishte mbajtur gjallë kujtimet, me Fyellin e Bariut, na ofroi një histori të paharruar.

Gjatë atyre ditëve që ka qëndruar në Prishtinë, Kodra është takuar me shumë intelektualë edhe me disa personalitete të larta politike të atyre viteve. Me ta njihej nga vitet e rinisë kur kishin qenë bashkë si nxënës në konvikt e gjimnaze në Shqipëri. Meqenëse dihej se Kodra nuk ishte njeri me anime politike me qëllime të afirmimit kombëtar, njëri nga politikanët nga elita e politikës së lartë të atyre viteve në Kosovë i propozoi Kodrës me respekt që pikturat e sjella për hapjen e ekspozitës në Prishtinë, t'i ekspozojë edhe në Beograd.

Kjo ide Kodrës i pëlqeu dhe pas mbylljes së ekspozitës në Prishtinë, pikturat e veta i la në duar të fatit të përealizuar. Ajo ekspozitë në Beograd nuk u hap.

Pse nuk u hap nuk di ta them, por pikturat e Kodrës mbetën me vite e vite në doganën e Kosovës.

Kur u doli gjumi shqiptarëve ishte bërë tepër vonë...

Për qëndrimin e gjatë të atyre pikturave në depot e doganës, dogana me ligjet në fuqi i kishte konfiskuar ato dhe tani ato piktura nuk mund t'i merrte as Kodra vetë.

Detaje më të hollësishme nuk dimë. Por urdhri nga lart, duke ditur këtë punë dhe duke u bindur se e kanë lënë në harresë, u zgjodh një mundësi pak si më fatlume dhe u vendos që ato piktura dogana t'i jepte për Fondin e Muzeut të Artit Modern të Kosovës.

Për kohën, që nuk po na kujtohet bash mirë, dhe kohën që kërkon udhëtarë të rinj, Kodra na del si krijues i kënaqur me krijimtarinë e vet. Nuk e kam të qartë si i ka shpëtuar dhe si i ka lënë në harresë apo si i ka marrë pas vdekjes me veti shumë ngjarje të botës së vet dhe të jetës që e ka jetuar.

Në kujtimet e veta Kodra flet edhe për Kosovën, por me shumë pak ngjarje dhe realitete që i ka përjetuar gjatë atyre ditëve në Prishtinë.

Ato ditë e net të Kodrës, që i ka kaluar mes nesh në Kosovë, për të kanë qenë ëndërr e një vendlindje të dytë.

Pas tridhjetë viteve fati i vonuar e kishte sjellur të kalojë ca ditë në shtëpinë e vet mes vëllezërve dhe miqve nga Rrafshi i Kosovës.

Por Kodra kur i ka shkruar ato kujtime nga pleqëria e thellë, i kishte harruar ngjarjet që s' duhej t'i harronte.

Ekspozita e Kodrës e hapur në holin e Teatrit Kombëtar ishte ngjarje e madhe edhe për Kodrën, por edhe për ne në Kosovë. Në ekspozitë ishte edhe Bekim Fehmiu e Esad Mekuli dhe shumë krijues të tjerë të cilët gjatë atyre ditëve në Kosovë patën rastin e mirë që në rrafshin e vet me prezantimin e Ibrahim Kodrës ta shohin një copë Evrope.

Kodra në hapësirën e vet urbane, që nga fillimi krijoi largësinë e cila krijimtarinë e tij e bën më kreative, me urtësinë e heshtjes që e ruante si diçka që duhej të ndodhë.

Për të shkruar një autoportret, me legjendat e gjitha mundësive, mitin e jetës e fillon me atë që i kujtohet.

Interpretimi për të gjetur e për të parë e për të pikturuar edhe diçka që nuk e kishte të njohur jo për shkak të mosbesimit, të interpretimit ndryshe, por për hir të çelësit që e kishte gjetur, aty ku e kishte gjetur edhe vetveten, ndalet. Ndjehet mirë dhe beson se njeriu udhëton vetëm për ta gjetur vetveten. Për ta kapur fillimin, ngjyrat e Kodrës: e kaltra, e kuqja, e verdha. Për famën e tyre hapet dritarja, me qeshjen e një peme. Për Ibrahim Kodrën, optimistin e fundit të kubizmit, arti nuk është vetëm ajo që duket. Diçka tjetër që na thërret ka kuptim më të thellë.

Këtë kod me fushëpamjet e shtrira në pikturat e tij unë e shoh si vlerë me personalitet.

Po më vie ta kujtoj edhe piktorin italian Morandi, i cili gjatë tërë jetës ka pikturuar natyra të qeta vetëm në shishe.

Por ato shishe nuk ishin vetëm shishe. Ishin një botë e tërë me figurshmëri të shumë personaliteteve e të ngjarjeve...


Pak e çuditshme. Si mund të jenë edhe shisheet me gjitha këto kujtime ?...

Ndoshta Ibrahim Kodra, duke shkuar për të parë Muzikantët e Pikasos, i ka parë edhe Shisheet e Morandit dhe Autoportretin e vet në pasqyrën e re të kubizmit.

Ibrahim Kodra realizoi një art dhe kafshoi një mollë, aty dhe atëherë kur e pa jetën dhe ku e pikturoi ëndrrën e vet.

Më 1957 Kodra i sheh gjërat edhe jashtë rrethit të mbyllur në një ekspozitë bashkë me Marino Marinin, Alberto Kutuzan e shumë piktorë të tjerë të njohur italianë. Kritika e atyre viteve shkruan se Kodra përmes larmisë së një kubizmi të përparuar të viteve të pas luftës ka zbuluar historinë e hijeve të mozaikut bizantin dhe parashikimin e antikës së dytë të kodit të ndryshimeve. Nëse doni përgjigje të drejpërdrejta me roklin e vijave të drejta gjeometrike të trekëndëshave, katërkëndëshave, te pikturat e Ibrahim Kodrës e gjeni fotografinë e ëndrrave, me të gjitha kuptimet për njeriun që e kërkon ëndrrën e vet.

Portret,
bojë kine në letër,
60 x 43 cm,



Ibrahim Kodrës për hir të të vdekurve, përtej reve të zeza, reve të bardha, larg diku nga larg shpesh i vinte një thirrje e ngjashme me zërin e nënës si zë që nuk e kishte harruar as gjatë pleqërisë.

Me kalimin e viteve Ibrahim Kodra jetën e donte gjithnjë e më shumë dhe e harronte idenë e plakjes.

Me shembuj e imazhe figurative për ëndrra, shprehje, fillime, Kodrës edhe pse i ka munguar përkrahja për një jetë pak a shumë të lumtur në Milano, qytetin e studimeve, sukseseve dhe fillimeve, fati i punoi për të mbetur brenda besimit të vet shpirtëror.

Me vulën e kohës, që zbulon zjarrin dhe fjalën në fillim të fillimit, mes dy vijave të kuqe, asgjë nuk mund të ndodhë pa e marrë vesh ylli i fatit.

Për jetën e lumtur, Ibrahim Kodrës edhe pse i kanë munguar kujtimet e fëmijërisë, me një jetë të rrethuar nga vetmia, larg vendlindjes e përtej detit në botën e qytetëruar, duke prekur diçka të vërtetë me piktorët e kohës së vet bashkë me kohën, për një kujtesë drejt njeriut për ta pasuruar kujtesën, i varfër dhe i pasur, me botën e pikturave të veta, për t'i kapur largësitë e harruara e për t'i marrë me qetësi largësitë e reja, me të pafshehtat e fatit kërkonte qetësinë shpirtërore që i mjaftonte për ta parë një ëndërr.

Kjo fushëpamje e re, që është një hap përpara lavdisë ia vlen për të fluturuar si art, si rrëfim edhe brenda zjarrit.

Kur shohim diçka nga brenda, për ta hapur mendimin e për ta harruar shqetësimin, si mund të vlerësohet krijimtaria e Ibrahim Kodrës kur Ibrahim Kodrën e kemi larg?

Mos kërkoni diçka që s'është më.
Për ta kapur jetën, fotografia është fotografi.
Jeta diçka më shumë...

Pas kalimit të disa viteve me më shumë heshtje se fjalë, Ibrahim Kodrës si piktor puna filloi t'i ecë mirë.

Në Milano nga fama e artit të vetë jetonte mirë, por nuk e dimë se sa u ka besuar miqve, njerëzve, matematikës dhe artit për botën dhe vetvetes.

Edhe kur fatin e mori në duar të veta, vitet e fëmijërisë nuk i harroi.

Durrësi për të edhe pse ishte qytet i panjohur, për Kodrën s'kishte rrugë tjetër pos të ikte nga shtëpia e të shkonte në Durrës ku nuk e dinte se ç'rrugë po merr jeta e tij.

Në moshën, kur ende nuk na vjen t'i vlerësojmë as ëndrrat, as ndarjet, as udhëtimet, Ibrahim Kodra për ta kuptuar më mirë Ibrahim Kodrën, lë Durrësin. Kalon detin. Për të studiuar pikturën ndalet në Milano të Italisë, ku i kalon vitet më të mira të jetës. Për një fytyrë të re të historisë së artit modern, vazhdon rrugën.

Në udhëtime të gjata dhe të largëta shkon për të ardhur.

Duke regjistruar një kohë dhe një histori dhe duke shkuar pas kërkimeve dhe fillimeve, shumë mirë e dinte se çka duhet të kërkonte nga ëndrrat, kur vjen një kohë, kur shkon një kohë. Më mire se e vërtetë i dilte ëndrra që e pikturonte. Dhe i duhej të shtyhej me historinë e shkruar e të pashkruar të kohës së vet.

Kur koha e tashme dhe koha e shkuar, të lodhur nga kopjimi i natyrës bëhen botë e vogël, botë e madhe.

Me ngjarje dhe ndryshime idenë e harmonisë krijuese e kërkonte edhe brenda dekorimeve të arkitekturës orientale dhe bashkë me fragmente të tjera etnografike për shkak të besimit i kthente në vlera të reja figurative.

Me matematikë, muzikë e ngjyra, gjithmonë si e Bukura e Dheut. Si një çudibërje e mirë, aty e atje ku koha e të jetuarit na vjen si ëndërr që na zgjon nga gjumi.



4

Më 1996 Kodra për të rikujtuar ngjarjet, kujtimet, me barrën e viteve mbi supe, pas shtatëdhjetë viteve vizitoi vendlindjen - Ishmin, Durrësin, Tiranën...

Gjatë qëndrimit njëjavor në Shqipëri, Kodra takoi shumë krijues në Tiranë.

Atë realitet, duke e parë si të ishte në ëndërr, nuk besoi se mund të quhej e vërtetë.

Më 1998 Muzeu Historik Kombëtar dhe Galeria Kombëtare e Arteve me një prezantim të përbashkët shqiptaro-italian hap një ekspozitë të arteve figurative. Në atë ekspozitë Kodrës i caktohet vendi i nderit, si krijues i veçantë, me vlerë të veçantë. Ideja e atij prezantimi shqiptaro-italian ishte një prezantim me vlera kombëtare të dy popujve, të cilët i ndan një det, dhe i dy popujve që flasin drejtpërdrejt për poezinë dhe pikturën:

Me Diell Mediterani;

Me Hënë Orientale...;

Me Renesansë italiane;

Me Rilindje Shqiptare...

Në këtë histori të imazheve, Kodra ka lënë shumë piktura që asnjëherë s'i pamë.

Andeje këndeje, ato vepra deri tani nuk u vlerësuan nga shqiptarët.

Në pasqyrë, brenda pasqyrës, për të zgjuar ndërgjegjen historike është kënga popullore që na bashkon.

Por nga ata që nuk e njohin e nuk i prek teli i pikturës së Kodrës, nuk mund të pritet as ta kuptojnë, as ta vlerësojnë e as ta shijojnë emancipimin e arteve tona pamore.

Mendja e tyre do të mbetet si historia e Egjiptit, pa Sfinksin e Madh e pa piramidat e faraonëve.

Me fundin e heshtjes, fillimin e heshtjes, kur na kujtohen gabimet dhe kur i harrojmë gabimet, Ibrahim Kodra si piktor shikon qiellin.

Fiton shekullin.

Nga dashuria ndaj artit, nga pikturat e veta e largon mjegullën.

Për të çdo ditë ka qenë një agim i ri.

Ideja e kësaj ëndrre për ta bërë fshehtësinë e madhe të jetës realitet, Kodra e kishte vargun e një poezie të zgjedhur si pagëzim *"Mediterrani 1"*.

Për atë ekspozitë Goetano Grillo në parathënien e katalogut në krye të fjalës e kishte krijimtarinë e Ibrahim Kodrës. Duke kaluar përtej Guernikës dhe të asaj ngjarje kulturore, Grillo shkruan: "Piktorët e të dy vendeve janë ekspozuar në një arenë të vetme dhe në qendër të tyre për të sanksionuar përkatësitë natyrore dhe për përjetësimin e të dy vendeve tona, është një piktor me gjak shqiptari, por me formim italian, që quhet Ibrahim Kodra. Një ekspozitë organike me vepra historike të Ibrahim Kodrës nuk është organizuar kurrë në atdheun e tij dhe ajo përkon me tetëdhjetëvjetorin e lindjes së piktorit, i cili nga studioja e tij e Milanos nuk ka rreshtur kurrë së dashuri Shqipërinë e tij dhe të bënte aq sa mundte për të në çdo rrethanë".



Kuajt, 1975



Në emër të artit gjatë viteve 2000 kur në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë hapi ekspozitën e parë personale, Kodra atëherë ishte i plakur dhe nuk i shërbente më as vetvetes e as pikturës që e kishte krijuar, por i shërbente dikujt tjetër që e kishte maninë e tingëllimës së parasë. Prandaj me keqardhje po e them se ajo ekspozitë, që u prit me shumë dëshirë dhe entuziazëm, për të deri tani u fol shumë pak. Përshtypjet e shijes së hidhur e mbyllën edhe ekspozitën, edhe iluzionet,

edhe zhgënjimin. Por për ata që e kishin pak më të njohur krijimtarinë e Kodrës të viteve të pesëdhjeta, gjashtëdhjeta, shtatëdhjeta, të atyre pikturave që tani gjenden nëpër koleksione private e shtetërore në Itali e në shumë vende të tjera, ende i kanë të ruajtura përjetimet e vlerave të atyre pikturave.

Me fotografinë e një mode dhe rrezikun e një bukurie që ta kthen shpinën, përsëritja është e dhimbshme, por jo gjithmonë.

Për Ibrahim Kodrën, vetmia ka qenë për ta gjetur veten si piktor.

Në krijimtarinë e tij ka pak ndikime që mund të shihen si fakte të njohura e të shprehura më parë në botën e kubizmit.

Kjo festë, me origjinë pagane, i ka ndihmuar për ta gjetur më lehtë çelësin e për ta shprehur personalitetin e vet si piktor.

Tani kur dikush më pyet për Kodrën i them:

-Për ata që nuk e njohin veten, piktura e Ibrahim Kodrës është për ta njohur veten. Aty e atëherë kur shkojmë për ta kërkuar pasqyrën, në rrugë për ta njohur veten.

Te Guri i Shurdhanit kurrkush nuk di të flasë më mirë se përsëritja. Prandaj edhe një herë po them: Kodrës gjatë viteve të fundit të jetës së tij, pse i kishte kaluar e ikur interesimi për kërkime të reja, nuk di ta them se sa do të jetë një mëkat.

Për ta kornizuar jetën krijuese ndoshta e kishte shprehur vetveten. Nga ajo çka kemi parë e dëgjuar për jetën dhe pikturën e tij, mendoj se shqiptarët ende nuk e kanë parë në dritë të plotë Autoportretin e tij.

Edhe tani, me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes së Ibrahim Kodrës, nuk mund të japim vlerësime të plota, të sakta. Për ne shqiptarët e vonuar, udhëtimi i jetës së Ibrahim Kodrës ka mbetur një biografi pa shumë biografi. Ai shkoi dhe u harrua me vite.

Ai erdhi gjatë viteve të pleqërisë dhe u shfaq vetëm me disa piktura dhe riprodhime të viteve të fundit.

Kësaj ëndrre nuk ka kush që i del përpara e të na tregojë se kush ka qenë ky shqiptar që ka jetuar shtatëdhjetë vjet në Milano të Italisë dhe si ka jetuar e mbetur gjallë pa kontakte me shtetin dhe kombin e vet. Me një fjalë, ky prezantim mund të shfaqet vetëm si një ëndër e bukur, të cilës nuk i dihet as fillimi e as fundi. Për aq sa e njohim, për aq sa e kemi harruar, mos më pyetni më shumë.



Figurë gjeometrike,
teknikë e përzier,
50 x 35 cm,
1970

Hapësirë,
vaj në pëllhurë,
50 x 70 cm,
1961



5

Ibrahim Kodra gjatë orëve të krijimtarisë, askend nuk e lejonte që të ndikonte në të e ta lëvizte majtas apo djathtas.

Problemi më i vogël për të ishte spekulimi intelektual.

Për t'u mbrojtur nga Koha e Gurit e për të ikur nga Mjegulla Postmoderne, jetën e kuptonte si diku në mes.

Në atë mes, me ëndrrën e vet shikonte qiellin dhe pikturonte kapërcimin e ylberit.

Ky kod edhe pse përsëritej nuk e zbehte aq shumë vlerën e krijimtarisë së tij të krijuar vite e vite më parë.

Kodra ka pasur miqësi dhe ekspozitë kolektive edhe me Pikason dhe shumë piktorë të tjerë që ishin të njohur për historinë e shkruar e të pashkruar të arteve pamore.

Veprën e tij të plotë nga fillimi e deri tani nuk e kemi të njohur.

Për ta kapur Historinë e Hijeve, gjatë stinëve rodhi shumë ujë.

Aty ku hija hijen e shkel, Ibrahim Kodra para pasqyrës po më del fytyrë pak tragjike edhe pse arti i tij është muzikë.

I harruar nga fati dhe kombi vetëm aparati fotografik mund të ketë parë më mirë se ne, duke korrigjuar e duke lënë vetëm atë që është art, pra aty e atëherë kur shpesh ndodh të humbet edhe artisti.

Për Ibrahim Kodrën asgjë më shumë nuk po na kujtohet: Muzikantët, Bariu me Fyell, Idoli, Ushtarët në Parakalim..., të gjitha këto piktura për shqiptarët janë dhe s'janë dikund.

Në shqiptarhane për Ibrahim Kodrën shumëkush vetëm ka dëgjuar dhe thotë: Kodra është piktor i madh dhe aq!

Për ta vlerësuar dhe rivlerësuar artin tonë, ende është një mes.

E kuqja e famshme e Onufrit njëherë ka qenë ëndërr. Mandej harresë e më vonë duke mos e njohur fundin, doli në shesh.

Aty ku koha shton legjendën, harron legjendën.

Vlera më e bukur në krijimtarinë e Ibrahim Kodrës është humanizmi.

Në botën e qytetëruar të shqiptarhanes ka edhe shqiptarë që dinë diçka më shumë për vlerat e Ibrahim Kodrës.

Në fund të harresës dhe në fillim të kujtimeve Kodra shkruan: “Unë vetë arrita të zbuloj se vizatimi si lëndë studimi më sjell një gëzim pa kufi”.

Ky kujtim Kodrës i ka sjellur vetëm kënaqësinë e besimit në fushën e artit deri në fund të jetës...

Nëse dëshironi ta gjeni veten në pikturat që i krijoi Kodra, nuk bëni asgjë të re, por do t'i kaloni vetëm disa çaste të mira. Ky vit nuk është i kaluar. Nuk ka kohë të merret me gjëra, të cilat s'i kemi paraqitur si të kohës. Kur flasim për Kodrën në kuadër të kombëtares, ky shpirtërisht mbetet gjithmonë brenda jetës shqiptare. I ri, i pazëvendësueshëm, preciz. Kur u paraqit, çfarë date ishte për ne? Arti modern i këtij shekulli për ne shqiptarët fillon me Kodrën apo pas Kodrës? Kush do ta vlerësojë këtë punë? Rendi shtëpiak ende nuk dihet. Kodra nuk është ende sa duhet në mjedisin tonë. E lamë përtej detit...

Rexhep Ferri, Prishtinë, 2016



Urbanistika,
vaj në pëlhurë,
140 x 140 cm,
1984



VLERËSIMET NGA KRITIKA SHQIPTARE

Personaliteti i piktorit italian, me origjinë shqiptare, Ibrahim Kodra nderohet nga e gjithë bashkësia e artistëve shqiptarë. Artistët dhe themeluesit e së parës Shkollë të Vizatimit në Tiranë, i edukuan brezat e artistëve të ardhshëm me frymën e mirënjohjes dhe të kujtesës për te. Duke hulumtuar në shtypin shqiptar kam gjetur 74 shkrime me vlera njohëse, artistike, historike dhe publicistike rreth figurës dhe krijimtarisë së Ibrahim Kodrës.

“Kur hapëm Shkollën e Vizatimit, në fillim e kishim të vështirë për të gjetur talentë. Në atë kohë kisha vënë re se reklamat e filmave shkruheshin me fantazi, shoqëroheshin me vizatime të bukura. Mësova se i bënte një nxënës i Shkollës Teknike i quajtur Ibrahim Kodra. Pastaj pashë se kishte bërë dhe vizatime të tjera. E takova dhe i thashë nëse kishte dëshirë të regjistrohej në Shkollën e Vizatimit. Kam shumë dëshirë, mu përgjigj Kodra...”.

Odise Paskali
(AKS, 26 mars 1995).

“Kodra arriti më lart. Në Italinë e traditave të shquara në art, brenda pak viteve, ai zuri vend midis piktorëve më të shquar të kohës.

Duke pikturuar në një formë të re, tipike vetëm për Kodrën, me ekspozitat e shumta që hapi...vlerësohet si një nga përfaqësuesit e shquar të pikturës bashkëkohore europiane. Ndërsa në artin e diasporës shqiptare qëndron në krye. Veç kontributit që jep në artin botëror, Kodra është, gjithashtu, nga autorët më të rëndësishëm të diasporës për përjetimin e botës shqiptare në art...”.

Prof.Dr. Ferid Hudhri
(AKS, 26 mars 1995)

“...Krijimtaria artistike e Ibrahim Kodrës zë një vend të lartë në Panteonin e artit figurativ shqiptar e ndërkombëtar”.

Shyqri Nimani
(Rilindja, 1 korik 1992)

“...Mjediset kulturore-artistike në fillim të viteve '50 ishin çlirues të fuqishëm të energjive piktorike...Ata e vendosën Kodrën në sfondin e dukshëm të vlerave më të larta të pikturës europiane. Ky vend, që zuri në hapësirën e pikturës...erdhi si rezultat i dy faktorëve të rëndësishëm që ekzistonin brenda individit Kodra. Së pari, shpalosi një krijimtari të veçantë në sensin e të përceptuarit dh të impresionit mbi formën, mbi konstruksionin vizatimor, mbi ngjyrën...dhe, së dyti, mori përsipër të transmetonte burimet e pambaruara të morisë fantastike të ngjyrës burimore, incizimeve vizatimore të traditës shqiptare në artin popullor, tek i cili zbuloi realen e pasqyruar me naivitet të kultivuar, zbuloi abstrakten e lindur intuitivisht dhe dekorativitetin e ornamentit gjithëshqiptar...”

Suzana Varvarica - Kuka
(Drita, 21 prill 1996)

“...Piktori Kodra në Shqipëri mund të ketë lënë edhe punime të tjera ndër miq dhe të afërm të tij, por punimet e ruajtura në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë kanë një vlerë të paçmuar në biografinë artistike të mjeshtrit. Në këto punime padyshim ndjehet ndikimi i Shkollës së Vizatimit të Tiranës dhe influenca e dekorativitetit të punimeve artistike si qilima, gdhendje artistike dhe punime të artizanatit...Interesante është mënyra se si mjeshtri i madh i siglon punimet e tij të kësaj periudhe. Në peizazhin e titulluar “Qendra e Tiranës” ai e nënshkruan tablonë djathtas, poshtë duke vendosur gërmën e parë të emrit të tij I (Ibrahim) dhe mbiemrin e plotë Kodra. Në të dy punimet e tjera të vitit 1942, ai preferon të firmosë me një fjalë të vetme IbraKodra, duke vazhduar kështu të firmosë me këtë nënshkrim në të gjitha punimet e tij deri në ditët tona.

Ylli Drishti
(Drita, 21 prill 1996)

“...Në një anë krijimtaria e tij i referohet kërkimeve në artin modern, në anën tjetër, traditës konservatore popullore dhe fetare në Shqipëri. Simbolika e artit të Kodrës lidhet sa me Italinë sa me Perëndimin në përgjithësi, aq edhe me Shqipërinë dhe Kosovën në veçanti...Matriçia e idhujve të tij në të shumtën e rasteve...është një drejtkëndësh që, në raport me elementet që gërsheton Kodra, merr funksione sensuale, femër apo mashkull...”

Ylli Paruca
(Rilindja, 6 qershor 1998)

“Kodra. Një nga emrat më të mëdhenj të pikturës bashkëkohore italiane. Artist i përbotshëm i sukseseve të mëdha. Një nga zërat më të sigurt të pikturës së sotme. Kodra njëri nga artistët më cilësor të epokës sonë. Njëri nga eksponentët më të mëdhenj të artit bashkëkohës”.

Abdulla Tafa
(Kodra një univers, 1991)

KODRA – ARTISTI PËRTEJ DETIT


Për Kodrën, piktorin tonë modern, artisti i cili jetonte përtej detit, siç e quanim ne kosovarët në fund të viteve 60-ta, kisha dëgjuar dhe lexuar si i ri.

Më 2003 në Milano pata rastin ta vizitoja atelienë e tij. Aty nuk kishte shumë piktura. Ato tani na ishin shpërndarë në muzetë e botës dhe nga qindra reproduksione të cilat i pashë aty, vërehej qartë se piktura e tij ishte e frymëzuar nga ikonat bizante të vendlindjes. Ishin risi vizuale për qendrat e artit evropian të viteve të 60-ta. Figurat postkubiste të muzikantëve të tij tingëllonin me patinën origjinale të kulturës së lashtë ballkanike. Ndonjëherë piktura e tij duket se kalon caqe të realitetit duke u shndërruar në fantazi artistike. Ky ishte stili dhe jeta e tij, bikrijimi i figurës dhe i peizazhit brenda katrorëve në pëlhurë krijon një shprehje poetike moderne. Kodra duke kërkuar personalitetin e vet krijues, në pikturën e tij krijon një komunikim të ri vizual në mes të kaluarës dhe të tashmes.

Luan Mulliqi
(Shkurt 2006)

“...Në pikturat e tij theksohen tema shoqërore, vizatohen personazhe që kundërshtojnë shoqërinë e konsumit...Gjithashtu, në veprën e tij ai trajton tema kundër dhunës ushtarake, duke iu referuar shumë ngjarjeve të këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit. Një nga figurat e parapëlqyera të tij është ajo e Skënderbeut...Ai e studioi shumë këtë figure edhe për përmendoren që u punua në Bruksel më 1968, si dhe në vende të tjera të botës me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar”.

Luan Rama
(Zëri i Popullit, 3 qershor 1990)



Homazh Pikasos,
1975

SHKRIME PËR IBRAHIM KODRËN

Enforio MASTROLONARDO

Ibrahim Kodra e ka parë me interes polemikën me piktorët e brezit të tij. Ai ka lidhje të natyrshme me pjesën më të madhe të piktorëve italianë, por edhe dallime sepse është më i spikaturi ndër ta. Piktura e tij nuk njihet kufij nacionalë; ajo jeton në botën e qytetëruar me shumë dinjitet e individualizëm.

(Idea, 1936)

Paul RAPHAEL

Pas një eksperience të gjatë, ku provoi suksesin në neoklasicizëm, në kubizëm në pikturën abstrakte, Kodra kërkon akoma gjini të reja.

(L'Espoir, 1957)

Mario DEMICHELI

Kodra ka një eksperiencë të gjatë. Sot duket se ka arritur në majat e krijimtarisë së tij. Ka krijuar një pikturë moderne, gjithnjë në ngritje, e cila me imagjinatë i afrohet shumë Bizantit. Kodra ka disa muaj që me krijimtarinë e tij arrin në një gjendje sugjestionuese.

(L'Unita, 1957)

Max BOURDIN

Me veprat që ka krijuar ka shprehur shijen dhe dëshirat e tij personale dhe shpërthimet e brendshme. Duket se askush nuk ka të drejtë të çmojë e të mburret se i kupton pikturat e tij, sepse injorohet më thelbësorja e zbehet ajo që është thënë me aq finesë nga piktori. Të gjitha sipas tij janë observime të kujdesshme.

(Canes-Nice-Midi, 1958)

Vivien BOST

Ibrahim Kodra ka pikturuar muzikën e tij, mbretërinë e tingujve të flautit që rievokojnë lart mbretëritë e muziktarëve të Pikasos..., i pëlqen të qeshë me dikë, të indinjohet me dikë tjetër, por asnjëherë nuk qëndron indiferent. Suksesi i tij është mjaft i madh dhe i mirëpublikuar.

(Nice-Matin 1958)

Hans KINKEL

Piktori Ibrahim Kodra ekspozon në galerinë Senatore. Një takim tepër i këndshëm me të. Ai jeton në Milano dhe është cilësuar një nga piktorët më të mëdhenj italianë të gjeneratës së re. Në pikturën e tij ka një lidhje origjinale ndërmjet gjeometrisë e lirizmit. Kodra e don të kaltrën dhe e përdor në pikturat e tij në të gjitha nuancat; kjo ngjyrë është bërë një ndihmëse për shprehjen e emocioneve të brendshme, duke krijuar efekte të veçanta në pikturat tij. Për të gjitha të tjerat, Kodra është një talent i shquar e origjinal në pikturën e sotme.

(Stuttgarter Zeitung, 1959)

Enco FABIANI

Përshtypjet e para i krijova atëherë kur u gjenda përpara botës së madhe të pikturave të Kodrës në të cilat ekzotizmi oriental dhe mozaiku bizantin shfaqnin vlera të mrekullueshme në veprat e tij, të cilat për ne latinët ishin të paarrtshme. Dy motive vëhen re në këto vepra: figura sa të kapshme në peizazhet e pafundme, aq edhe groteske. Një ndjenjë e thellë, intime e poetike të jep kënaqësinë të shijosh në to "frymën" e tokës, të qiellit, të detit...

(Gente, 1959)

Leonardo BORGESE

Disa gjëra të zgjedhura nga e kaluara e të ruajtura me kujdes si një baritor me shpirt të madh e të mrekullueshëm, ruan brenda vetes piktura e tij mahnitëse. Shqetësimi i Kodrës është ai i kalimit nga racionalizmi në abstraksionizëm, i cili jep simbole të shumëduhura shpirtërore.

(Corriere de Ha Sera Milano, 25 Marzo 1961)

Guido BALLA

Kodra gjithmonë është marrë me figurën, por kësaj radhe nëpërmjet sugjestionit ka kaluar nga postkubizmi në metodën abstrakte. Ka personazhe që spikatin "toteme" të reja dhe ajo që është më e rëndësishmja, drejtimi i tij shkon shpesh drejt neobizantizmit. Kodra kthehet në veprën tjetër pa skema të jashtme pa shqetësime të mëdha, por me një sfond të gëzuar, i shoqëruar shpesh nga tone të larmishme në të gjitha kuadratet mahnitëse.

(Presentazione, 1961)

Mario STEFANILE

Nuk është e lehtë piktura sado e dashur të jetë ajo, kur çdonjëri shkon e gjen valën në dlijësinë e saj, një mendim të pathënë ndonjëherë - thotë Ibrahim Kodra në një dialog të sinqertë mes miqve të tij.

(Presentazione-II tarlo Napoli, marzo 1972)

Franco RUSSOLI

Ibrahim Kodra merr pjesë qe pesëmbëdhjetë vjet në jetën artistike italiane dhe mund të themi se është personazh i hapësirave të mëdha e të pakufishme në kulturën e re milaneze. Në veprën e tij ka ruajtur me kujdes një karakter thellësisht origjinal nga paraardhësit e tij ballkanikë.

(Presentazione, 1965)

GATI-GATI NJË SIMBOL UNIVERSAL

Carlo BO

Emri i Kodrës më çon shumë prapa në vite. Ka kaluar pothuajse gjysmë shekulli që kur ai ndodhej në galerinë Santa Radegonta të Renco Bertoni. Gjatë kësaj periudhe kaq të gjatë sa shumë suksese për të, sa lavde nga miq të përbashkët, nga Joppolo te Valeschi, nga Testori, i cili qe ndër të parët që e shuguroi e deri te Raffaelino de Grada. Gati një simbol përgjithësues, nëse është e vërtetë që e hasim të përpiktë në çdo pikëtakim të rëndësishëm, në udhëkryqet e shndërrimeve të pafund që ka njohur arti gjatë këtij gjysmëshekulli. Po si vallë e zbuluam dot dhe si e gjetëm atë tani? Ai i qëndron besnik prejardhjes dhe frymëzimeve të tij të para nga natyra dhe e gjithë kjo, pavarsisht nga funksionet e shumta që ka shfaqur në kishat e avangardës evropiane, flet se kemi të bëjmë me një piktor vërtet të madh. Mund të thuhet se në Milano, ose më saktë në klimën tashmë mitike të Brerës së viteve pesëdhjetë, ai kapi mrekullinë për të pajtuar imazhet antike të botës së tij orientale me skemat që vinin nga Parisi, përkatësisht ende nga Parisi dhe për ca kohë. Me ëmbëlsinë e tij Kodra ia doli mbanë në një mishmash tejet të ndërlikuar, ku si element bazë zotëronin tradita dhe shpirti modern, ndërsa vendlindja është atdheu që dilte nga shkatërrimi e dhembja.

Në këtë mënyrë ai u bë zëdhënës (pa rënë kurrë peng i aktualitetit) i pjesës më madhështore e më të vërtetë të zemrës së vet. Të qenit i huaj dhe i largët e vinte në kushte të privilegjuara, tej pasioneve të ndezura dhe të zjarrta dhe më pranë kuadrit të amshuar të njeriut: shkurt ai ishte një arbitër dhe në të njëjtën kohë një krijues që hodhi rrjetat e frymëzimit në një kuadër tashmë të çliruar nga kufizimet e shkollave dhe kodeve zyrtare.

Gjithë këtë spektatori mund ta shpalosë edhe vetë falë një meditimi më të thellë; për këtë mjafton të vëhet përballë kësaj galerie të pafund fryti i një këmbënguljeje dhe një vëmendjeje të jashtëzakonshme për të parë se si Kodra është në të njëjtën kohë jashtë dhe brenda botës. Ajo që funksionon si trait-d'union e si instrument lidhjeje është rrjeti që ndan dhe bashkon përsëri kuadrot e tij, kjo shenjë e përhershme që shërben edhe si burg, edhe si shpjegim. Lexuar për së mbari, kjo shenjë e përhershme, kjo pikë referimi e përrjetshme do të thotë se piktori, sado i vetëdijsëm për kufijtë që i vë realiteti, gjithsesi është përherë i lirë të lëvizë përtej këtyre caqeve dhe mbi gjithçka të përfshijë atë që quhet frymëzim-reagim përballë objekteve të fantazisë së tij të plagosur. Por ka dhe ca më shumë. Ky rend i ngritur nuk do të kishte ekzistuar sikur më parë shpirti i artistit të mos kishte qenë magjepsur nga lëvizja e përrjetshme e objekteve, e simboleve dhe e klithmave të realitetit. Thua se ai desh të rindërtonte gjithçka, që gërryhet e kalbet nga spektakli i përditshëm, dhe është pothuaj gjithçka. Avangarda veçanërisht. Kubizmi i pati nxënë vlerën e shpërbërjes së sendeve; Kodra mori masa për ribërjen e tyre në njëfarë kornize të përgjithshme për të cilën kritiku ndodhet gjithmonë përballë diskutimit të temës së marrëdhënieve ndërmjet shpërbërjes dhe bërjes.

Me fuqinë për t'u përballur me këtë drejtim të pakapërcyeshëm të caktuar, Kodra është bërë gjithnjë e më i qartë derisa i dha rendit të tij një konfigurim gjeometrik. Bie fjala, të marrësh e të shohësh një kuadër si ai që ia përkushtoi Pozitanos, aty me të vërtetë që merr formë dhe shpaloset përleshja e moçme, antike midis traditës dhe revolucionit, por njëkohësisht ti e ndjen edhe rregullin që nuk e mbyllet pjesën tjetër, një rend ende si brumë dëshire, njohjeje dhe risie. E s'kish si të ndodhte ndryshe: në harkun e një gjysmëshekulli ka kohë të mjaftueshme për t'i dhënë artit tënd një imazh të lirë, të çliruar nga pasiguritë dhe nga keqkuptimet e pashmangshme të së sotmes.

Kështu, pra, dalëngadalë Kodra u bë zot dhe mjeshtër i rrugëzgjidhjeve të tij dhe të gjithçkaje tjetër që shikonte në veprën e shokëve e veçanërisht përballë zërave të mëdhenj që kokëfortësisht i vinin në kujtesë: zërat e artit oriental, të një bote të kapërcyer me fuqinë dhe mbështetjen e prirjes së tij të parë. Jo rrallë kam pyetur veten se cilat qenkan arsyet, ngacmimet më të fshehta që e soiën në këtë pikë, apo thënë ndryshe si ia doli mbanë të bashkëjetojë e të përçojë dritën e madhe të Orientit në mjegullën e vogël të Breras dhe kësaj gjithmonë i jam përgjigjur fare thjesht: duke kapërcyer nga Shqipëria në Milano, piktori nuk u korruptua, as u shpërbë; shpërngulja e ndihmoi të kuptojë më mirë atë që kanë dashur të bëjnë mjeshtrit parizienë dhe atë që ata bartnin nga pas. Ja pra, ende nuk e gjejmë të trupëzuar në shkolla apo vende të tjera të formimit dhe ende sot e shohim të përqendruar në tretjen e kujtesës gjigante në kuadrot e shumta të krijimeve të tij. Veçanërisht të befason fakti ku përgjithësisht një artist me kulturë tjetër që prek truallin e artit evropian është krejt i gatshëm të jepet, të imitojë dhe të sforctojë tonet e zërit të tij.

Në fakt Kodra ka zgjedhur rrugën e ballafaqimit kritik, kështu që ka mund të saldojë shijen, madje nevojën e të resë me pjesën e pashlyeshme të fjalës së tij antike.

Por as kjo s'mjafton. Pjesën më të ndjeshme të vlerësimeve që ka pasur e përsëris, janë vlerësime të kritikës më të besueshme, pra këto i janë atribuar pasi piktura e Kodrës kishte një funksion të veçantë, një funksion prej pasqyre.

Duke vendosur veten përballë rezultateve të këtij rikrijimi të pafund, kritika ka pasur mundësi të verifikojë dhe të dallojë saktësisht. Dora që bënte kallëzimin për një prejardhje tjetër dhe për një edukim të ndryshëm shndërrohej në një instrument preciziteti për të kuptuar e gjykuar se çfarë bënin ndërkohë miqtë milanezë, shokët e bohemës së fundme lombardiane.

^{vx}I huaji u bë kështu padashje një gjykatës në kuptimin që gjithçka që ai kish mësuar nga fqinjët e tij merrte një rol më të spikatur dhe kështu shërbente si pranim apo mohim i asaj që Apoliner e quan l'espritnouveau.

Kjo ishte ndërmarrje mjaft e guximshme pasi gjithë ky kapitull shkruhej dhe rishkruhej shumë vite pas epopesë kubiste, e më vonë edhe surrealistike dhe duhesh përbaltur detyrimisht me katalogun e avangardës, e cila ndërkaq i përkiste historisë. Ngulitet në Milano, pra duke mos zgjedhur Parisin, siç ndodhte rëndom me shpirtrat e tokës. Kodra pati një ndjeshmëri të lumtur: kishte kuptuar se nganjëherë gjërat shihen më mirë nga larg dhe se pasioni i vërtetë gjendet më lehtë në paqen, prehjen e meditimit dhe studimit. Dhe aspak rastësisht njëri prej imazheve më solide të veprës së tij dëshmohet pikërisht në këtë përpjekje të arsyes për të burgosur realitetin, për ta ankoruar atë në dritën e së vërtetës dhe të së besueshmes.

(Milano, mars 1987)



Kompozim,
vaj në kompesatë,
30 x 40 cm,
1954

KODRËN E BËRI TË MADH BESIMI NË VETVETE

EPOKA E RE: Njohja juaj me Kodrën?

Ferri: Me Ibrahim Kodrën kam pasur fatin të njihem gjatë viteve '60 kur kam qenë student dhe mund të them se kam një lidhje të vogël me këtë krijues kaq të madh.

EPOKA E RE: Kur keni dëgjuar për herë të parë për të?

Ferri: Si fillim kam dëgjuar ose lexuar për të nga një revistë italiane e artit ku ishte prezantuar edhe i madhi Kodra si një krijues i madh në fushën e pikturës. Dhe, një gjë që mua më ka bërë përshtypje ishte se atje pothuajse ishte nënvizuar që Ibrahim Kodra ishte piktor shqiptar, dhe mua më ka mbetur në mendje që një revistë italiane e vinte në dukje dhe e evidentonte si një piktor të shquar Ibrahim Kodrën, ashtu si edhe ishte.

Pas kësaj ndjeva një krenari të ligjshme që më buronte dhe më bënte të ndjehesha mirë shumë, sepse kisha momente në të cilat ndjehesha i vetmuar në atë botën time në të cilën merresha me poetikën e artit. Unë aty pashë se edhe ne shqiptarët e kemi një traditë.

EPOKA E RE: Kur ka ndodhur për herë të parë takimi konkretisht?

Ferri: Gjatë udhëtimit të parë për në Paris jam ndalur në Milano. Aty jam takuar dhe jam njohur me Ibrahim Kodrën. Kur kemi shkuar në studion e tij kam parë se aty ishin të gjitha portretet ose fotot e shqiptarëve më të mëdhenj të historisë sonë, dhe edhe të rilindësve tanë. Pra, ai në mes të Milanos kishte një Shqipëri të vogël, që më është dukur se ishte edhe për mua. Dhe kjo Shqipëri e gjetur në studion e Kodrës i humbi vlerat e poezisë së Migjenit që flet për atë fëmijë që mezi e gjen në hartë Shqipërinë. Për mua në ato momente u be diçka e madhe e cila mori përmasat reale të cilat edhe i ka.

EPOKA E RE: Në çfarë piedestali e vendosni piktorin Kodra?


Ferri: Me kalimin e kohës, me ngritjen e nivelit tim në fushën e artit erdhi duke u ngritur edhe njohja me veprimtarinë e Ibrahim Kodrës. Vetë koha në të cilën ai ka vajtur në Itali ka qenë një periudhë ekzistence kur edhe Shqipëria edhe Italia kishte këto probleme që të gjithë i dimë. Pas Luftës së Dytë Botërore çdokush do e kishte vështirë që të mbijetojë jo më të merrej me krijimtari artistike, aq më shumë elitare. Duke jetuar në këtë periudhë këtu del edhe madhështia e Kodrës. Ai nuk mposhtet dhe merret me krijimtarinë e vet, madje me krijimtari elitare do të thosha. Kështu ai kurrë nuk është dorëzuar dhe nuk është pajtuar me atë gjendje të cilën ia imponon koha në të cilën ka jetuar. Ai ka bërë përpjekje duke u ngritur madje edhe në shoqëritë elitare të kohës. Dhe për hir të së vërtetës, duhet thënë se që të bësh vend në Italinë e Da Vinçit, Mikelanxhelos duhet të jesh vërtet i madh, dhe ai me talentin e vet dhe me punën e vet ia arriti që shumë shpejt ta ketë vendin e vet. Po ashtu edhe të jesh bashkëkohës dhe mik me Pikason, edhe kjo nuk do shumë komente. Në vitet '50 – '60 ka qenë ndër krijuesit shumë të njohur në Itali, në Francë etj.

Intervista ime për gazetën "Epoka e re" me rastin e vdekjes së Ibrahim Kodës dhënë gazetares Ylldije Sylka. Botohet në mënyrë integrale me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes.

Prishtinë, shkurt -

Në Kosovë ne kemi pasur fat të komunikojmë me piktorin Ibrahim Kodra shumë më herët për arsye të cilat dihen. Pra ai ka ardhur në Kosovë në: 1968, para se të vinte në Tiranë, ose kur nuk mund të vinte në atë kohë në Tiranë dhe në vendin e tij të lindjes. Dhe kjo ardhje ka qenë për të si një rilindje e dytë sepse ai ishte larguar nga vendlindja në vitet '30 dhe nuk ishte kthyer më asnjëherë. Dhe përherë të parë pas pothuaj 30 viteve ai foli përsëri shqip. Gjatë kohës që ai ndenji këtu ne kemi marrë shumë nga ai. Sidomos sa i përket rrymës së modernizmit që ai ushtronte në krijimtarinë e vet", ka thënë një intervistë për "Epokën e re", profesori dhe piktori i njohur Rexhep Ferri.

O.T.
akrilik në letër,
70 x 50 cm,
1983



EPOKA E RE: Si e cilësoni Kodrën?

Ferri: Kohë më vonë kam dashur të bëj një portret për të. Jam ndalur dhe kam pyetur veten se çfarë figure është Ibrahim Kodra. Edhe pse krijimtaria e tij është shumë optimiste, me plot kolor, ndjenjë dhe mjeshtëri, përsëri më doli se figura e Kodrës është një figurë mitoepike. Dhe kjo më dukej sepse duke e krahasuar me figurat e tjera jo vetëm bashkëkohore, por edhe më tej dilte se kishin të gjithë mbështetjen shtetërore të tyre. Ndërsa ai nuk e kishte këtë dhe nga kjo më dilte se ai ishte ashtu, pothuajse një mit. Veprat e tij më të mira dhe më të mëdha janë nëpër duartë e njerëzve dhe koleksione private, por jo në muzetë e njohur dhe të mëdha të botës. Dhe kjo do bëhet në të ardhmen, por do ende kohë.

EPOKA E RE: Kur dhe si njihet në Kosovë Ibrahim Kodra?

Ferri: Në Kosovë ne kemi pasur fat të komunikojmë me të shumë më herët për arsye të cilat dihen. Pra, ai ka ardhur në Kosovë në 1968, para se të vinte në Tiranë, ose kur nuk mund të vinte në atë kohë në Tiranë dhe në vendin e tij të lindjes. Dhe kjo ardhje ka qenë për të si një rilindje e dytë sepse ai ishte larguar nga vendlindja në vitet '30 dhe nuk ishte kthyer më asnjëherë. Dhe për herë të parë pas pothuaj 30 viteve ai foli përsëri shqip. Gjatë kohës që ai ndenji këtu ne kemi marrë shumë nga ai. Sidomos sa i përket rrymës së modernizmit që ai ushtronte në krijimtarinë e vet.

EPOKA E RE: Sa njihet Kodra në trojet shqiptare?

Ferri: Njohja e Kodrës në Kosovë është më e madhe dhe më e hershme, pikërisht për këtë ardhje. Dhe edhe më vonë, ai është më i njohur këtu sesa në Tiranë. Dhe për këtë është një fatkeqësi që ai nuk është njohur më herët atje, në Tiranë. Dhe periudha kur ai ka ardhur aty ka qenë në moshë të shtyrë dhe edhe kryeveprat e tij nuk janë të njohura për publikun shqiptar atje. Dhe kjo është vërtet një fatkeqësi, por që koha do ta riparojë.

EPOKA E RE: Kodra dhe folklori?

Ferri: Në tërë atë rrymë moderniste të vepra e vet, ai ka gjetur mjeshtëri dhe ka futur edhe frymën kombëtare dhe folklorin e vet. Dhe këtë e ka bërë me kaq mjeshtëri të artë sa që rrallë mund ta shohim te piktorë të tjerë. Kështu p.sh., modelet 2 banesave tona të klasës së lartë në strukturën e tyre, me ngjyrat dhe me format tejet të holla artistikisht, ai diti t'i hedhë në art dhe kjo ishte një freski për veprën e tij edhe një dalje nga ndikimet e kubizmit dhe çlirimi i një bote të tërë tek ai. "(Kubizmi i tij ishte një kubizëm shumë origjinal. Në këtë kubizëm frymon me jetën tonë tipike shqiptare, me legjendat tona. Kur themi tipike shqiptare kjo është më e saktë, sepse ne edhe pse kemi qenë të varfër, kemi qenë krenarë dhe kjo na ka imponuar që të jemi dhe në majat e klasave të kohës pa lënë aspak poshtë. Këtu mund të kemi shembujt e Kel Marubit që në fotot e tij kemi malësorë me pushkë nga më të zbukuruarat me ar dhe me filigrane tepër luks për kohën.

EPOKA E RE: A është Kodra një "Pikaso" shqiptar?

Ferri: Pikaso shqiptar.... nuk është problemi që ne t'i themi Kodrës "Pikaso" shqiptar.

Sax
akrilik në letër,
50 x 35 cm,
1989



EPOKA E RE: Apo mund të themi vetëm Ibrahim Kodra?

Ferri: Një fakt është i vërtetë-Ibrahim Kodra është piktor modern shqiptar. Dhe me këtë ai ka ditur që ta marrë folklorin duke e modernizuar. Sepse folklori ka një veti, të mban "mbërthyer" dhe të imponohet. Ndërsa ai, Kodra e ka tejkaluar këtë me guxim duke e modernizuar veprën e vet.

EPOKA E RE: Çfarë e ka bërë të madh Kodrën?

Ferri: Kodrën e ka bërë shumë të madh besimi në vetvete. Ai shumë i ka besuar punës së vet. Dhe me këtë besim ka ecur përpara duke u bërë ai që tashmë të gjithë e njohim, por jo vetëm ne, e gjithë bota, sidomos ajo artistike. Më ka bërë përshtypje, por jo vetëm mua, se sa i madh është Kodra. Dhe jo vetëm si piktor, por Kodra si njeri. Po iu jap vetëm një fakt. Kur e pyesin për Kadarenë, ai përgjigjet me një shprehje të thjeshtë. "Kadare është kombi". Ndërsa unë besoj dhe do të shtoja që për artet figurative "Ibrahim Kodra është Kombi".

EPOKA E RE: Sa ka bërë Prishtina për Ibrahim Kodrën?

Ferri: Më vjen shumë mirë që ne në Kosovë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës duke marrë parasysh rëndësinë dhe seriozitetin e vlerësuesve profesionalë krijues Ibrahim Kodrën e pranoi si anëtar të vetin me korrespondencë.

EPOKA E RE: Po Tirana?

Ferri: Më në fund edhe në Tiranë i janë bërë nderet që i takojnë, duke e nderuar në këtë mënyrë veten e tyre dhe më vjen shumë mirë për këtë. Kjo më gëzon, sepse ne nuk kemi njerëz për të humbur.

EPOKA E RE: Cilat tablo janë për ju më të mëdhatë te Kodra?

Ferri: Një tablo që mua më ka pëlqyer është "Parakalimi i ushtarëve", dhe mund të them se asnjë vepër të këtij cikli ne nuk e kemi këtu në Kosovë. Po ashtu janë ciklet "Muzikantët", "Deti". Do të thosha se edhe një cikël tjetër është jo vetëm i mrekullueshëm, "Idoli". Dhe kjo tek ai ka qenë domosdoshmëri, sepse nëse ne e kemi pasur një idol si "Ora", që ne shqiptarët e kemi si ndihmë. Dhe edhe ai ka plotësuar nevojën të ky cikël. Te ky cikël ai jep idenë e një idoli mbas të cilit shkon një brez. Po ashtu një cikël tjetër po aq shumë i njohur është edhe "Muzikantët". Por jo muziktarët e rrugës. Ndoshta një lloj muzikantësh si ai vetë i ka përfytyruar. Ndoshta ka qenë ai vetë. Sepse Kodra sa herë që shkonim në shtëpinë e tij, shihnim një kitarë. Dhe ai vetë i binte asaj herë pas here. Dhe më ka ndodhur që pasi jemi kthyer nga darka në shtëpinë e tij, ai i binte vetë dhe këndonte këngë të vjetra shqipe.

"EPOKA E RE", e shtunë, 18.II.2006


Dashuri,
akrilik në letër,
73 x 51 cm,
1982



REPRODUKSIONET



Tirana, vaj në pëlhurë, 67 x 90 cm, 1938



Figurë femërore, vaj në pëlhurë, 63 x 46 cm, 1947

Vrasja e nënës, vaj në pëlhurë, 1945





Tri figura, vaj në pëlhurë, 60 x 73 cm, 1957




Figura dhe idoli, vaj në pëlhurë, 60 x 73 cm, 1958




Kompozicion VI, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1967



Kompozicion, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1967



Veçanti, vaj në pëlhurë, 60 x 80 cm, 1966




Deti, vaj në pëlthurë, 80 x 100 cm, 1966



Kompozicion V, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1967



Kompozicion II, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1967



Kompozicion I, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1967



Kompozicion, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1967



Kompozicion, teknikë e kombinuar, 80 x 60 cm, 1978




Fund deti, vaj në pëlhurë, 50 x 70 cm, 1964



Kompozim, vaj në pëlhurë, 110 x 60 cm, 1962



Kompozicion III, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1968



Kompozicion IV, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1968



Kompozim, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1968



Fundi i detit, teknikë e kombinuar, 50 x70 cm, 2000



Fundi i detit, teknikë e kombinuar, 50 x70 cm, 1996



Struktura e hapësirës, teknikë e kombinuar, 30 x 40 cm, 1999




Vizione, vaj në pëlhurë, 60 x 50 cm, 1987



Grua në pasqyrë, vaj në pëlhurë, 810 x 100 cm, 1960



Lule në natyrë, vaj në pëlhurë, 100 x 80 cm, 1960



Muzikantët, vaj në pëlhurë, 100 x 80 cm, 1961



Kompozicion, vaj në pëlhurë, 100 x 80 cm, 1960



O.T., vaj në pëlhurë, 50 x 35 cm, 1966



Kompozicion, vaj në pëlhurë, 100 x 80 cm, 1960



Një rreze dielli, vaj në pëlhurë, 50 x 70 cm, 1968



Kompozicion, vaj në pëlhurë, 100 x 80 cm, 1960



Pa titull, teknikë e kombinuar, 30 x 40 cm, 2000



Kompozim, teknikë e kombinuar, 50 x 40 cm, 2001



O.T., teknikë e kombinuar, 80 x 60 cm, 1974



Kompozim, bojë kine në letër, 35 x 49 cm, 1962



Nga cikli: Arti konkret, vaj në pëlhurë, 60 x 70 cm, 1951




Nga cikli: Arti konkret, vaj në pëlhurë, 60 x 70 cm, 1951




Kapri, teknikë e kombinuar, 70 x 50 cm, 1997



Kapri, teknikë e kombinuar, 70 x 50 cm, 1997



Kapri, teknikë e kombinuar, 70 x 50 cm, 1997




Varkat në orët e mengjesit, vaj në pëlhurë, 50 x 46 cm, 1973




Peshqit, vaj në pëlhurë, 60 x 73 cm, 1958




Shqipëria fantastike, teknikë e kombinuar, 100 x 150 cm, 1997



Tre peshqit, litografi, 65 x 48.5 cm, 1960




Marinarët, litografi, 65 x 48.5 cm, 1960



Loja me peshqit, vaj në pëlhurë, 34.5 x 50 cm, 1972

Kompozim me peshq, vaj në pëlhurë, 55 x 46 cm, 1975



Ilya Kuvshinov




Familja e peshqve, vaj në pëlhurë, 50 x 70 cm, 2003



Kompozim me peshq, vaj në pëlhurë, 25 x 20 cm, 1964



Loja e peshkut, vaj në pëlhurë, 46 x 55 cm, 1971




Kompozim me peshq, vaj në pëlthurë, 25 x 20 cm, 1964



Peshkatari, vaj në pëlhurë, 100 x 100 cm, 1974




Pa titull, vaj në pëlhurë, 100 x 100 cm, 1974



Peshqit, vaj në pëlhurë, 92 x 73 cm, 1974



Kompozicion, vaj në pëllhurë, 92 x 73 cm, 1974



Peshqit, vaj në pëlhurë, 100 x 100 cm, 1974



Peshkatori, vaj në pëllhurë, 100 x 100 cm, 1974




Nga deti, vaj në pëllhurë, 55 x 46 cm, 1975




Figurë me peshk, vaj në pëlhurë, 70 x 80 cm, 1998




Në kërkim të idhujve të ri, vaj në pëlhurë, 80 x 100 cm, 1968




Ata kërkojnë paqe, vaj në pëlhurë, 80 x 80 cm, 1968



Personi i vetmuar, vaj në pëlthurë, 80 x 80 cm, 1967



Konformistët, vaj në pëllhurë, 50 x 60 cm, 1968




Personat, vaj në pëlhurë, 60 x 80 cm, 1968




"Confidence", vaj në pëlhurë, 60 x 73 cm, 1976




Lulet, vaj në pëlhurë, 60 x 80 cm, 1968



Nusja e re, vaj në pëlhurë, 50 x 40.5 cm, 1974



Takimi, vaj në pëlhurë, 50 x 60 cm, 1968



Nëna me fëmijë, vaj në pëlhurë, 60 x 80 cm, 1968




Muzika (Teatro Masimo), vaj në pëlhurë, 70 x 50 cm, 1973




Arkeologu, teknikë e kombinuar, 150 x 100 cm, 2003





Kompozim, vaj në pëlhurë, 70 x 80 cm

Totem rozë, vaj në pëlhurë, 25 x 35 cm, 1974



Lidhja e Prizrenit, Skënderbeu, Arbëria dhe arbëreshët, serigraf



Ëndra e një gjenerali, vaj në pëlhurë, 1972

Lufte për pushtet, vaj në pëllhurë, 80 x 120 cm, 1972








Luftë për paqe, vaj në pëlhurë, 180 x 120 cm, 1997



Luftë për pushtet, vaj në pëlhurë, 80 x 120 cm, 1972



Flautistet, bojë kine në letër, 48.5 x 64.5 cm, 1972

Muzikantėr, vaj nē pēlhurē, 70 x 80 cm





Muzikantët, vaj në pëlhurë, 80 x 80 cm



Muzikantët, vaj në pëlhurë, 80 x 70 cm



Fyelli, akrilik në letër, 51 x 36 cm, 1989



Fyelli, akuael në letër, 44 x 38 cm, 1989



Egiziana, vaj në pëlhurë, 80 x 80 cm, 1976



Idoli me instrument afrikan, vaj në pëlthurë, 65 x 87 cm, 1976



Muzikë popullore, 80 x 80 cm, 1987



Instrumentisti, vaj në pëlhurë, 65 x 87 cm, 1976



Bariu, vaj në pëlhurë, 68 x 80 cm, 1969



Muzikanti, teknikë e kombinuar, 35 x 50 cm, 1968



Familje muziktarësh, akrilik në pëlthurë, 34 x 24 cm, 1971



Mësim muzike, vaj në pëlhurë, 54 x 65 cm, 1977



Basisti, vaj në pëlhurë, 64 x 48.5 cm, 1974



Djali me flautë, vaj në pëlhurë, 55 x 46 cm, 1975



La Dolce Melodia, vaj në pëlhurë, 54 x 65 cm, 1977



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlthurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikntari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1972



Muzikari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1973



Muzikntari, (Teatro Massimo), vaj në pëlhurë 70 x 50 cm, 1971



Këngëtari, qeramikë



Adami dhe Eva, basoreliev në argjend



22
Zur Kootna



Totem me fruta, naj në pëlthurë, 70 x 50 cm, 1977

Totem me fruta, teknikë e kombinuar, 18 x 24 cm, 1984



Vajza që krifet, vaj në pëlhurë, 35 x 25 cm, 1972



Dimensioni i tretë, vaj në pëlhurë, 70 x 60 cm, 1959



Totem, qeramikë



Totem, skulpturë



Monument, Tiranë



Monument, Tiranë

Biografia

Ibrahim Kodra u lind në Ishëm të Durrësit në vitin 1918. Fëmijërinë e kaloi në atmosferën e vështirë ekonomiko-politike të Shqipërisë së pas Luftës së Parë Botërore.

Në mesin e viteve tridhjetë, Kodra pasi kishte kryer arsimin e përgjithshëm, u fut në shkollën e sapohapur të artit në Tiranë, të quajtur “Shkolla e Vizatimit”.

Më pas, në vitin 1938, duke përfituar nga marrëdhëniet e ngushta mes Mbretërisë Shqiptare të Ahmet Zogut dhe Italisë, Ibrahim Kodra arriti të marrë një bursë studimi për në Akademinë e Arteve Brera në Milano.

Ai u shpërngul në Itali ku studioi pikturën me profesorët Carra, Funi e Carpi. Pas studimeve akademike, Kodra u shpërngul në Milano ku hapi edhe atelieun e tij, ndonëse kjo përkoj me periudhën e vështirë të mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Ai u bë shpejt pjesë e ekspozitave të rëndësishme kolektive që organizoheshin në Itali, por edhe në Paris, (Francë) duke filluar që nga viti 1948 e duke vazhduar përgjatë gjithë viteve pesëdhjetë të shekullit XX. Në këto ekspozita ai merrte pjesë krahas artistëve më të njohur të Evropës. Karriera e tij artistike kulmoi me pjesëmarrjen në Ekspozitën e Universitetit të Parisit në vitin 1953, ku ekspozonin njëkohësisht Picasso, Chagall, Matisse, Modigliani etj. Që nga ai moment Kodra u bë një piktor i njohur në Itali dhe më gjerë, duke ekspozuar individualisht në muze e galeri të ndryshme evropiane e madje edhe në SHBA, në New York. (Princess Hall Gallery, 1963).

Në vitin 1973 Ibrahim Kodra u dekorua nga Akademia Franceze e Arteve e Shkencave dhe e Letërisë. Ai jetoi dhe punoi deri në fund të jetës së tij (2006) në atelieun e tij në Milano, në sheshin Ragosta.

Ekspozitat personale të përzgjedhura:

- 1949 Cavallino Gallery, Venecia, Itali
- 1957 Berganini Gallery, Milano, Itali
- 1968 Galeria e Prishtinës, Prishtinë, Kosovë
- 1973 Rizzardi Gallery, Milano, Itali
- 1975 Guglielmo Tell Gallery, Chiasso, Itali
- 1986 Tasso Gallery, Bergamo, Itali
- 1987 Studio F-22, Pallazzolo sull'Oglio
- 1988 Pallazo Comitini, Palermo, Itali
- 1990 Art Studio 71, Palermo, Itali
- 1997 Galeria “TE&GI”, Tiranë, Shqipëri
- 2000 “I musici di Kodra”, Hotel Terme Sibarite, Cassano, Itali
- 2003 Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, Shqipëri

Ekspozitat kolektive të përzgjedhura:

- 1953 University of Paris, Paris, Francë
- 1954 Montenapoleone, Milano, Itali
- 1987 Studio “Denise Fiorani”, Piacenza, Itali
- 1968 Rijekë, Kroaci
- 1984 Frankfurt, Gjermani
- 1988 “II Novecento a Palazzo Isimbardi”, Milano, Itali
- 2002 III Manifesta Azzuro – “Arte Internazionale per la pace”, Itali

Bibliografi e përzgjedhur:

- 1992 Tafa, Avdulla, “Kodra një univers”, Tiranë, Botimi I, Enti “ART”
- 1995 Franza, Carlo, “Un’ idea su Kodra”, Severgnini Editore (MI)
- 1996 Centro, Paolo Borsellino – Palermo, “Ibrahim Kodra e il Teatro Massimo”
- 2002 Europe Campo Editions “KODRA”
- 2003 Fusca, Francesco, “Poeti per KODRA”, con illustrazioni di Ibrahim Kodra, Grafosud
- 2002 “II Gattopardo Arte” – “Una collezione illuminata”





Ibrahim Kodra - vizitë Presidentit të Kosovës Ibrahim Rugova



Ismail Kadare me Ibrahim Kodrën



Ibrahim Kodra në studio



Ibrahim Kodra në ekspozitën personale në Itali



Studio e Ibrahim Kodrës



Varri i Ibrahim Kodrës në vendlindjen e tij
Ishëm, afër Durrësit

Rexhep Ferri

Ibrahim KODRA

(MONOGRAFI)

Botues: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Lektor: Shefqet Riza

Redaktor teknik: ASHAK

Dizajni: Zeni Ballazhi

Formati: 25.5 x 31 cm

Madhësia: 20.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 300 copë

Viti: 2016

Shtypi: Fokus Print, Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

75.036(084.1)
929(496.5)Kodra, Ibrahim

Ferri, Rexhep
Ibrahim Kodra : (monografi) / Rexhep Ferri. -
Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës,
2016. – 163 f. : ilustr. ; 26x31 cm. - (ASHAK : Botime të
Veçanta ; CLVIII : Seksioni i Arteve ; Libri 22)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze

ISBN 978-9951-615-63-1